THE MIRDITË REGION DURING THE ERA OF THE PASHALIK OF SHKODRA

KRAHINA E MIRDITËS NË KOHËN E PASHALLËKUT TË SHKODRËS

Eduard NDRECA

Abstract

This topic will address the entire relationship of the Mirditë region and its leaders with the Pashalik of Shkodra and specifically with each individual Pasha from the Bushatli dynasty, covering tensions, armed conflicts, periods of peace, agreements made and joint commitments.
The relations of Mirditë with the Pashalik of Shkodra fluctuate from one extreme to another. Initially, the Mirditë people fought against the pashas of Shkodra, but later they complied and entered into agreements with them, establishing mutually beneficial agreements. The Bushatlis family recognized the rights previously granted to Mirditë by the Sublime Porte, while the Mirditë people would serve in their wars with potential contingents of Mirditë soldiers. The Mirditë people participated in almost all the wars fought by the Bushati family of Shkodra, as long as the relationship between them was stabilized.
The people of Mirdita did not limit themselves to cooperating only with the Bushatllis. Throughout the existence of this pashalik, they almost continuously maintained their relationship with the Sublime Porte, except at the moment of the fall of the Pashalik of Shkodra. We will also address in this study the relationship of the Mirditors with Ali Pasha of Janina, tracing it from its inception to its eventual breakdown, and exploring the reasons behind this rupture.
The crisis between the Bushatlis and the Sublime Porte divided the Mirditors in their positions. Some sided with the Bushatllis, standing and fighting with them until the last moment. Some chose the old ally, the Ottomans.
The collapse of the Pashalik of Shkodra restored very quickly the close cooperation between people of Mirdita and Sublime Porte, wich entailed the Porte's respect for the rights of Mirdita, while the people of Mirdita would continue to provide military service wherever the Ottoman government required.

***

Mirdita është një krahinë shumë e veçantë në veriun e Shqipërisë. Në fillimet e pushtimit osman ajo u bë një vatër e fortë qëndrese, duke e vënë veten shpesh në ballë të kryengritjeve që shpërthyen në veriun e vendit. Pasi qëndresa antiosmane filloi të venitej, krahina e Mirditës arriti të ndërtonte një raport të ri me pushtuesin. Kështu, mes tyre u lidh një lloj aleance. Mirditës i njiheshin disa të drejta e nga ana tjetër mirditorët duhej të furnizonin me ushtarë ushtrinë osmane, sa herë qeveria ua kërkonte. Ky pakt, me ulje-ngritjet e tij, zgjati gjatë tërë pushtimit osman të Shqipërisë.
Në kohën e pushtimit osman një kapitull shumë të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë zënë pashallëqet shqiptare, ku një nga më të rëndësishmit ishte ai i Shkodrës. Në kohën e ekzistencës së Pashallëkut të Shkodrës raporti i këtij pashallëku me krahinën e Mirditës përbën një çeshtje mjaft të rëndësishme. Kjo për faktin se mirditorët tashmë ishin mjaft të njohur si aleatët e vegjel të perandorisë së madhe. Ishin të njohur po ashtu për homogjenitetin e tyre, forcën ushtarake që kishin dhe për shumë gjëra të tjera, të cilat sëbashku e kishin bërë raportin me këtë krahinë të lakmueshëm nga çdo fuqi lokale apo më gjërë.
Mehmet pashë Bushatlliu mori më 1756 nga Sulltani të drejtën e sundimit brez pas brezi të Pashallëkut të Shkodrës dhe nga ky moment ai do krijojë një raport të veçantë edhe me mirditorët[1]. Mirdita filloi gradualisht ta lidhte ngusht interesin e vet me familjen e Bushatllinjëve. Edhe kur ato tentuan të dilnin nga sundimit osman, një pjesë e krerëve të krahinës së Mirditës mbajti krahun e tyre. Ishte forca e kontigjenteve mirditore, që i bënte ato të lakmueshëm nga çdo fuqi e brëndshme dhe e jashtme. Porta e Lartë i donte për vete,

[1]Arkivi Qëndror i Shtetit (më tej AQSH), fondi *"Zef Harapi"*, nr. 586, dosja nr. 116, viti 1929, f 8.

https://doi.org/10.62792/ut.icfra.y2026.i2.pp104

pashallarët e Shkodrës po ashtu, madje dhe pashai i Janinës. Edhe shtetet tona fqinjë i kontaktuan ato shpesh për t'i pasur në krah kundër Portës apo në luftëra të tjera që bënin.
Jo që në fillim Mehmet pasha i pati raportet e mira me mirditorët. Mendohet se i pari i mirditorëve, Gjon Marku, më 1769 luftoi kundër Mehmet pashës, kur ky i fundit u nis me ushtritë e tij për të nënshtruar Lezhën dhë Zadrimën. Në këto kushte Hysejn Beu dhe Tahir Beu u organizuan për t'u mbrojtur ndaj sulmit të pashait të Shkodrës, duke i kërkuar ndihmë edhe Gjon Markut të Mirditës, i cili pranoi dhe erdhi me shumë njerëz nga Mirdita e katunde të tjera[2]. Në betejën e 2 prillit 1769 në Pistull forcat e Lezhës, Zadrimës dhe të Gjon Markut arritën t'i bënin ballë me sukses sulmit të pashait të Shkodrës, i cili kishte me vete 2000-2500 ushtarë[3]. Megjithatë, qëndresa do thyhet. Dështimi në këtë luftë bëri që pashai i Shkodrës t'i fuste nën kontrollin e vet territoret që i dolën kundër, konkretisht Lezhën, Zadrimen dhe Mirditën. Pra, pas vitit 1769, ra kontrolli i sanxhakut të Dukagjinit mbi këto krahina, të cilat kaluan tashmë nën sanxhakun e Shkodrës[4]. Duke u ndalur pak te Mirdita mund të themi që nuk ishte e lehtë për pashain e Shkodrës ta nënshtronte atë, siç bëri me krahinat e tjera. Kjo për shkak të largësisë, terrenit e shumë faktorëve të tjerë. Gjithësesi me sa dukët mirditorët e njohën pushtetin e pashait të Shkodres, çka do ndikojë në ndërtimin e një raporti të ri mes krahinës së Mirditës dhe Pashallëkut të Shkodrës.
Shumë shpejt pashai i Shkodrës i rregulloi marrëdhëniet me Mirditën, duke lënë menjëanë luftën e vitit 1769. Normalisht, ky rregullim i marrëdhënieve lidhej me nevojën e Mehmet pashës për të shfrytëzuar siç thamë forcën ushtarake të mercenarëve mirditorë, të cilët ishin bërë të njohur për trimëritë e tyre në luftërat përkrah Portës. Në këmbim të këtij pakti Bushatllinjtë i njohën Gjon Markut, që hyri në shërbimin e tyre, funksionin e kryebajraktarit të pesë bajrakëve të Mirditës, funksion i trashëgueshëm në linjë mashkullore[5]. Theksoj se jo të gjitha punët në Mirditë i drejtonte vetëm ky kryebajraktar, pasi Mirdita kishte një formë të veçantë organizimi politik. Këtë formë organizimi e përkufizon më së miri Hecquard, kur shkruan se kjo krahinë ishte një lloj republike aristokratike. Kështu, kapedani nuk mund të merrte asnjë vendim pa pëlqimin e pleqve dhe bajraktarëve të mbledhur në kuvend[6]. Ja si e përshkruan më në detaje dhe e përforcon atë që thamë më sipër udhëtari anglez Henri Tozer, i cili vizitoi Mirditën më 1865. Ai shkruan se: *„Kushtetuta e Mirditës është një kushtetutë e aristokracisë ushtarake. Ndonëse e ka kreun trashëgues dhe kuvendin ku përfaqësohet i tërë populli, ç'është e vërteta, pushteti u takon krerëve të familjeve"*[7].
Gjon Marku, prijësi i mirditorëve, mendohet se u vra me 2 prill 1775 në Peçin, kur po luftonte kundër ushtrive të Ahmet Kurt Pashës së Beratit dhe përkrah sundimtarit të Shkodrës[8]. Ai mbeti i vrarë *"me gjashtëdhjetë nga trimat e tij, të gjithë të krishterë"*[9]. Me të mbetën dhe 4000 gegë të tjerë, ndërsa ushtritë e Mehmet pashës u thyen keqas[10]. Pas vdekjes së Gjon Markut në drejtimin e Mirditës erdhi Lleshi, djali i tij. Ky, edhe për faktin se vdiq shpejt, nuk shquhet për

[2]*Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë. Shqipëria nën sundimin feudal-ushtarak otoman*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Intituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, vëllimi III (1506-1839), pergaditur nga Injac Zamputi, Stavri Naçi dhe Zija Shkodra (Tiranë; Mihal Duri, 1961), „Pjesë nga një ditar i kohës në Shkodër. – Mehmet pashë Bushati zhvillon luftën në Zadrimë", fq 223.
[3]Stavri N. Naçi: "*Pashalleku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllijve (1757-1796)"*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë (Tiranë: 1964), fq 94.
[4]Po aty, fq 94.
[5]*Histori e popullit shqiptar.* Vëllimi I. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Botimet "Toena". Tiranë, 2002, fq 537.
[6]Hyacinthe Hecquard: "*Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së epërme ose i Gegërisë"*. Përktheu nga frengjishtja dhe pajisi me shënime Oriana Tamburi, Plejad 2008, fq 217.
[7]Robert Elsie: *"Fiset shqiptare. Histori, shoqëria dhe kultura".* Përktheu nga anglishtja Prof. Dr. Abdullah Karjagdiu. "Botime Artini". Prishtinë, 2017, fq 323.
[8]Pal Doçi: *"Mirdita vatër e qëndresës antiosmane",* shtëpia botuese "Mirdita". Tiranë, 1999, fq 145.
[9]*Shqipëria e veriut në shekullin e XVIII (Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë, 6),* Akademia e Shkencave e RPSH, Intituti i Historisë. Letra të Zev. Konsujve venedikas të Shkodrës, vëllimi II (1757-1802), pergaditur për botim nga Stavri N. Naçi (Tiranë: 1975), "Andrea Duoda njofton, qëkur rronte vezir Mehmet Pasha kishte mosmarrëveshje me Ahmet Kurt Pashën e Beratit prandaj konfiskoi mallin e Dhimitër Beratit, që tregëtonte me të hollat e pashës së tij. Pas vdekjes së vezirit plak, në Shkodër u dërgua vezir Mehmet Pashë Kystendili, por Sanxhaku i Shkodrës nuk iu bind dhe Mustafa Pasha Bushatlliut, në betejen e Peqinit u kthye. Aty mbeti i vrarë edhe Gjon Marku i Mirditës me 60 vetë të tij", fq156.
[10]Stavri N. Naçi: "*Pashalleku i Shkodrës (1796-1831)",* Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1986, fq 22.

luftërat e bëra edhe pse ishte burrë i qënë. Ai mbahet mend vetëm për faktin se u mori bejlerëve të Pejës Bajrakun e Fanit, që e sundonin ata[11]. Ky pati tre djem, Prengën, Dodën e Lleshin (Lleshi i Zi), të cilin e la pa lindur akoma, ku Prenga, si më i madhi që ishte, zuri vendin e babait të tij[12]. Duke e parë të ri në moshë, do shohim pak më poshtë se si qeveritarët e Shkodrës menduan ta likujdonin atë dhe të drejtat e Miridtës, duke shkuar deri në vrasjen e bashkëpunëtorit të tij më të ngushtë brenda familjes, Kolë Gjon Markut. Por lufta me Mirditën nuk u doli si menduan, ndaj pas një periudhe konfliktesh do t'i rikthehen dhe njëherë paktit mes tyre.

Mirditorët filluan të llogariteshin ndër ushtarët më bësnikë, përveçse të Portës, tashmë edhe të pashallarëve të Shkodrës. Më 1785, kur Kara Mahmut Pasha mësyu Malin e Zi e mori Cetinjen, Preng Lleshi i Mirditës me shumë mirditorë përbënin një kontigjent të rëndësishëm të ushtrisë së tij[13]. Pashai i Shkodrës hyri në Cetinjë, dogji e shkatërroi shumë, zuri robër lufte, pushtoi vendin e duke parë se në atë vend mungonte uji, hapi disa puse, të cilët më vonë u quajten puset e Kara Mahmutit[14]. Po në vitin 1796 u mblodhën shqiptarët që të shkonin për të nënshtruar Malin e Zi, që nuk ishte dukë lënë gjë pa vjedhur nga ana e Podgoricës dhe e Shpuzës. Në këtë luftë u erdhi në ndihmë edhe Preng Lleshi i Mirditës[15]. Gjithsesi, për shkak të një grindje mes tyre, mirditorët dhe shumë luftëtarë të tjerë nuk luftuan krah Mahmut Pashës. Ishte e premte. Mirditorët nuk donin të hynin në luftë, sepse sipas tyre ditë të premtësh nuk u shkonte luftimi mbarë. Edhe malësorët e tjerë u ndanë dysh, ndaj Mahmuti mbeti me pak vetë dhe në këtë luftë u vra, ndonëse luftoi me heroizëm[16].

Nuk vonoi shumë dhe miqësia mes mirditorëve dhe pashallarëve të Shkodrës filloi të çahej, sa për një përiudhë kohe, jo vetëm u prishën, por dhe u acaruan tej mase marrëdhëniet mes tyre. Mendohet se shkak i prishjes ishte vrasja e Kolë Gjon Markut. Kur Porta nisi përpjekjen për të shtypur kryengritjen serbe më 1806, në këtë luftë mori pjesë dhe Ibrahim pashë Bushatlliu. Me forcat e këtij të fundit u rreshtuan dhe shumë mirditorë nën drejtimin e prijësit të tyre Kolë Gjon Marku, i cili me sa duket u dënua me vdekje në zonat ku po luftohej, çka shkaktoi rebelimin e mirditorëve dhe kërkesën e tyre për t'u kthyer pa mbaruar lufta[17]. Marrëveshja e Portës me serbët, por dhe largimi i mirditorëve nga fushat e betejes pas vrasjes së prijësit të tyre, e detyruan Ibrahim pashën të tërhiqej[18]. Normalisht, ky moment shërbeu si shkak i acarimit të marrëdhënieve mes Mirditës dhe Bushatllinjve. Aq më tepër ky acarim u shtua kur bëhej fjalë se prijësin e Mirditës e ekzekutuan kot në Vidin vetë pjestarë të Bushatllinjve[19]. Pra, vetë pashai i Shkodrës e dënoi me vdekje dhe arsyet ishin të paqarta[20]. Mendoj se Bushatllinjtë tentuan të përfitonin nga rasti për të asgjesuar njërin nga prijësit kryesor të Mirditës, që t'i hapnin rrugën vetes e më pas ta pushtonin krejt krahinën. Kjo do u mundësonte atyre t'i siguronin vetë ushtarët mirditorë në luftëra, pa pasur nevojën e kompromiseve me kryebajraktarin apo bajtaktarët e tjerë. Mirditorët u prekën thellë nga tradhtia dhe vrasja e Kolë Gjon Markut. Më shumë u prek Preng Lleshi, kapedani i Mirditës, i cili e konsideronte atë krahun e djathtë të tij në drejtimin e krahinës. Mirdita nuk i duronte dot të tilla prerje në besë, ndaj ka të gjitha mundësitë, që për të çuar nderin në vend, Preng Lleshi u prish me pashain e Shkodrës.

[11]Pa autor: "*Dera e Gho Markut a e Kapidanit Mirdites"*, revista "Albania", viti 1898 (Dzhvillim B), nr 8, fq 131.
[12]Po aty, fq 131.
[13]Zef Harapi: "*Mirdita në histori e gojdhana deri në vjetë 1929"*, revista "Hylli Dritës", vjeta VII, 1931, nr 1, fq 43.
[14]Dom Ndoc Nikaj: "*Historia e Shqypnis".* Ribotim i shtypshkronjes "Nikaj" (botimi i parë është bërë në Bruksel me 1902). Shkodër, 1916 (mundet edhe 1917 ose 1918), fq 116.
[15]Pa autor, *Dera e Gho Markut….,* fq 131.
[16]Ludwig von Thalloczy: "*Të ndodhunat e Shqypnis prej nji Gege që don vendin e vet"*, përktheu nga gjermanishtja Stefan Zurani, transkriptoi, dokumentoi e komentoi Raim Beluli (Shkodër: Botime Françeskane, 2008), fq 185.
[17]Naçi, *Pashalleku….(1796-1831)*, fq 50.
[18]Po aty, fq 50.
[19]Pa autor, *Dera e Gho Markut*…., fq 131-132.
[20]Elsie, *Fiset shqiptare…..,* fq 330.

Prishjen e Mirditës me Bushatllinjtë filloi ta përdorë Ali pasha i Janinës. Ky i fundit e shikonte me xhelozi të madhe afrimin mes mirditorëve e Bushatllinjve, pasi frikësohej për forcën që merrnin në këtë rast këto të fundit. Ai mendonte se pa dyshim ato këtë forcë do e përdornin për t'u zgjeruar territorialisht. Sipas Dom. Ndoc Nikës prishja e mirditorëve me Ibrahim Pashën dhe afrimi i tyre me Ali Pashën erdhi për faktin se pashai i Shkodrës, në luftën që përmendëm më sipër, e preu në besë prijësin mirditorë, i cili në këtë rast u nda prejt tij dhe për shtatë vjetë vijoi lufta mes tyre. Po sipas tij mirditorët u ndihmuan dhe u përkrahën në këtë rast nga pashai i Janinës, të cilit i levërdisnin ngatërresat në veri, pasi ishte i interesuar në zbehjen e fuqisë së Bushatllinjëve[21].

Në këtë situatë inatesh e ngatërresash edhe nga jashtë konflikti i armatosur ishte i pashmangshmëm mes palëve. Për shtatë vjet me radhë u përpoq Ibrahim Pasha ta nënshtronte Mirditën, e cila sulmonte dhe plaçkiste territoret e tij, por nuk mundi dot dhe madje vdiq pa e nënshtruar[22]. Kam theksuar më sipër se për shumë arsye nuk ishte i lehtë pushtimi i Mirditës. Pashallarët e Shkodrës u munduan ta pushtonin pa e njohur mirë këtë krahinë, madje tentuan të bënëin atë që se kishte bërë as Porta e Lartë deri në atë moment.

Në këto kushte lufte si kundërvënie ndaj Ibrahim Pashës mirditorët lidhën aleancë të fortë me pashain e Janinës, që ishte i interesuar, siç shihet më sipër në atë që shkruan Dom Ndoc Nikaj, për dobësimin e Shkodrës e Bushatllijve, duke mbajtur gjallë ngatërresat në viset veriore. Preng Lleshi i çoi Ali Pashës disa ushtarë mirditorë nën urdhërat e Dodës, djalit të tij, dhe Lleshit të Zi, që e kishte vella. Këto e ndihmuan shumë atë në luftën që bëri për të shtënë në dorë Shqipërinë ë Poshtme[23]. Megjithatë, kur më vonë pashai nisi luftën kundër Portës së Lartë e për këtë thirri dhe një kuvend, përfaqësuesit mirditorë e kundërshtuan[24]. Pakti i vjetër me Portën e Lartë për mirditorët qëndronte mbi çdo marrëveshje tjetër. Nuk ishte e lehtë t'i bindje t'i kundërviheshin Portës, aq më tepër kur ajo i kishte respektuar vazhdimisht. Megjithatë, mirditorët vijuan të shkonin në shërbim të Ali Pashës, përveçse kundër turqve, ku u dalluan në luftërat që ai bëri.

Megjithëse e mbështeten pashain e Janinës, banorët e Mirditës nuk mund të pranonin në fakt të ishin skllevër të veprimeve të askujt, as të Ali Pashës, ndaj dhe shumë shpejt mes tyre do fillojë një krizë e thellë, që do çojë në ndarjen përfundimtare mes tyre. Si shkak i parë shërbeu kërkesa absurde e Ali Pashës ndaj trupave mirditore për të shfarosur banorët e zënë rob të Kardhiqit e të mbyllur tek hani i Valaresë. Zef Harapi shkruan në kujtimet e tij se Ali pasha kishte mbyllur në këtë han të gjithë meshkujt e çdo moshe të Kardhiqit, me qëllim t'i mbyste. Ishte ditë e premte, 15 mars 1812, pasdite, kur Ali Pasha thirri mirditorët që i mbante per roje të tij, pasi ishin pjesa ma e zgjedhur e ushtrisë. Të gjithë ishin katolik. Këtyre u dha urdhër të hynin në oborr të hanit dhe të vrisnin ato që ishin brenda. Por mirditorët nuk ia çuan në vend urdhërin duke iu përgjigjur: *"na nuk mundena kurrsesi me vra njerëz të pa armë",* çka dëshmon dhe karakterin burrëror dhe prej malësorësh të vërtetë të mirditorëve[25]. Po për këtë ngjarje dhe për refuzimin e mirditorëve për të bërë masakren e kërkuar nga Ali Pasha, Mustafa Merlika-Kruja shkruan: *"Por ka burra Shqipnija: "Na s'e kemi zakon me vramë kend me duer lidhun ose pa pushkë", thanë Mirditasit, shkandulluem, qi ndryshe, ndër të gjitha luftat ishin vramë per te besnikisht e trimnisht"*[26]. Komandanti i mirditorëve në këtë rast përmendet njëfarë kapedan Ndrek Gazulli, i cili i qenka drejtuar Ali Pashës se me urdhërin që po jep për të vrarë njerëz pa armë po i çnderon mirditorët. Me tej ai i paska thënë se ne jemi në shërbimin tënd,

[21]Nikaj, *Historia….,* fq 126.
[22]Po aty, fq 126.
[23]Pa autor, *Dera e Gho Markut….,* fq 132.
[24]Harapi, *Mirdita në histori....,* fq 230.
[25]AQSH, fondi nr. 586, dosja nr. 116, viti 1929, f 29-30.
[26]Mustafa Merlika – Kruja: "*Shkrime historike",* Tiranë, OMSCA-1, 2011, fq 380.

por jo xhelatët e tu[27]. Duke qënë se komandati i mirditorëve, Ndrek Gazulli, kundërshtoi urdhërin, pashai i Janinës e largoi me gjithë mirditorët nga territoret e tij[28].
Ndërkohë që shërbenin tek Ali Pasha, mirditorët nuk e harruan dhe konfliktin me Bushatllinjtë, madje e tendosen shumë situatën. Ato sulmuan shpesh pjesë të territoreve të Ibrahim Pashës. Ky i fundit më kot u mundua ta nënshtronte Mirditën. Ekspedita e nisur kundër tyre në drejtim të malit të Kreshtës për të kaluar pastaj në Mirditë e për ta shkelur atë dështoi, pas pritës që Preng Lleshi me trimat e tij i bëri në këtë mal, ku flitej se nuk ishte më shumë se vetë i shtati[29].
Duke përfituar nga vala e kryengritjeve që shpërthyen në Pashallëkun e Shkodrës pas vdekjes së Ibrahim Pashës, sërish mirditorët nuk qëndruan duarkryq. Ata përfituan nga rasti dhe sulmuan e plaçkitën me 3 dhe 4 mars të vitit 1810 fshatra të shumtë, që ishin në krah të pashait të ri të Shkodrës, Mustafait, i cili po luftonte ndërkohë të zinte fronin e lëshuar nga Ibrahim pasha[30].
Pak ditë pas këtyre ngjarjeve, Mustafa Pasha, më anë të fermanit të sulltanit u njoh si qeveritar i Shkodrës. Sapo mori detyrën, pashai i ri rinisi sulmet në Zadrimë, ku u përplas me forcat e Preng Lleshit, që kishin zënë vend në Naraç. Por, Preng Lleshi, i mbetur pa ndihmën e komandantit të Lezhës, Sulejman Agës, dhe i braktisur nga shumë përkrahës të tij, u thye dhe ashtu i plagosur siç ishte iku nga Zadrima[31]. Megjithatë, edhe shumë herë mirditorët e sulmuan në befasi Zadrimën, duke shqetësuar forcat e Mustafa pashës dhe duke ngjallur dhe mosbesim në banorët e zonës.
Gjatë kësaj kohe nuk munguan as përpjekjet për marrëveshje mes palëve, por që nuk po konkludoheshin. Në shkurtin e viti 1813 rinisi konflikti mes Mustafa Pashës e kapedanit të Mirditës. Kapedani i Mirditës sërish kërcënoi Mustafa Pashën se do hynte në Zadrimë dhe do e pushtonte atë. Në këto kushte presioni, pashai i Shkodrës urdhëroi të arrestoheshin gjithë mirditorët që ndodheshin në tregjet e qyteteve që qeveriseshin prej tij, numri i të cilëve arriti në 90, si dhe urdhëroi mbylljen e këtyre tregjeve për Mirditën[32]. Ky pa dyshim do ishte një bllokim ekonomik me pasoja për krahinën e Mirditës. Por, si kundërpërgjigje Preng Lleshi i Mirditës arrestoi tregtarët shkodranë që po ktheheshin nga një panair i mbajtur në Strugë, si dhe i ndihmuar nga 50 maqedonas, sulmoi Zadrimën duke grabitur e djegur fshatra, kryesisht Mjedën. Mustafa pasha organizoi forcat e tij dhe detyroi kapedanin e Mirditës të tërhiqej, duke lënë 7 të vrarë e 30 të plagosur[33]. Në këto kushte kapedani i Mirditës dërgoi një përfaqësues në Shkodër për të bërë marrëveshje, pasi ishte rënduar gjendja ekonomike e banorëve të tij. Marrëveshja si fillim u mbyll me lirimin e të arrestuarve të dy palëve dhe heqjen e bllokadës ekonomike për mirditorët[34]. Megjithëse u bë kjo marrëveshje akoma situata mes dy palëve mbeti e nderë dhe kapedani i Mirditës priste rastin për t'iu kundërvënë sërish Mustafa Pashës.
Edhe në vitin 1815, para se të vinte marrëveshja përfundimtare e bashkëpunimit, pati konflikte të ashpëra mes Mustafa pashës dhe Preng Lleshit të Mirditës. Prenga, në këtë kohë lidhi marrëveshje me disa kryengritës shkodranë, të cilët kishin planifikuar të merrnin kalanë e Shkodrës. Në këtë moment Prenga me forcat e tij zbriti në Zadrimë. Dështimi i kryengritësve shkodranë bëri që Mustafa Pasha të drejtonte lirshëm ushtrinë e tij ndaj kapedanit të Mirditës. Sulmi i pashait të Shkodrës e detyroi Prengën të tërhiqej në malin e Kreshtës, ku dhe u zhvillua një betejë e madhe mes mirditorëve dhe malësorëve të Mbishkodrës, që shërbenin në krah të

[27]P. Margjokaj: "*Epizode historike nga koha e Ali Tepelenës. Kerdija në popullsin e Kardhiqit", r*evista "Shejzat", viti II, 1958, nr. 3-4 (Mars-Prill), fq 99.
[28]Pal Doçi: *"Vetëqeverisja e MIRDITËS".* Shtëpia Botuese Enciklopedike. Tiranë, 1996, fq 5-6
[29]Pa autor, *Dera e Gho Markut…..,* fq 132.
[30]Naçi, *Pashalleku….(1796-1831)*, fq 87.
[31]Po aty, fq 89.
[32]Po aty, fq 119.
[33]Po aty, fq 119-120.
[34]Po aty, fq 120.

Mustafa Pashës. Shumë nga forcat e pashait të Shkodrës mbetën të vdekur e të plagosur, ndërsa në anën e kapedanit të Mirditës pati vetëm dy të vrarë[35].

Duke parë se përpjekjet për të mundur Mustafa Pashën po dështonin me radhë, Preng Lleshi i Mirditës u detyrua të hynte në marrëveshje, pra të bënte paqe me pashain e Shkodrës e të lidhej më të, duke pranuar bindjen ndaj autoritetit të tij. Në këmbim të bindjes ndaj tij, Mustafa Pasha, me 25 nëntor 1815, siç kishin bërë dhë vezirët paraardhës, e konfirmoi me shkrim shtëpinë e Gjon Markut si shtëpi e parë në Mirditë[36]. Në këtë urdhër shkruhej: *"Lartmadhëria jonë dhe e vezirit Mustafa Pashë Shkodrës së Shqipërisë e kemi njohur gjithmonë shtëpinë e Gjon Markut dhe ju nderojmë lartë si të parin e Mirditës, të cilin e kanë njohur edhe stërgjyshërit e mi dhe ungji ynë i divanit"*[37]. Hecquard shkruan në fakt se paqen e kërkuan Bushatllinjtë. Konkretisht, ai shkruan se Mustafa Pasha u detyrua të blinte paqen me mirditorët, pasi ishte i lodhur nga luftërat dhe i frikësohej përhapjes së revoltave në krahinat e tjera katolike të vendit nën nxitjen e mirditorëve[38]. Me çfarë do shohim më poshtë ka mundësi të ketë ndodhur tamam kjo. Në këmbim të paqes mes tyre, Mustafa Pasha, jo vetëm i njohu si derë të parë, por u lëshoi pak më vonë mirditorëve edhe bajrakun e Dibrit, që deri në atë moment ishte nën administrimin e Shkodrës[39]. Në vitin 1818 tre bajrakët e Ohrit, Kthella, Selita dhe Bushkashi u shkëputën nga rajoni i Matit dhe ju bashkuan Mirditës. Po në atë vit u bashkuan me Mirditën dhe katër bajrakët e Malësisë së Lezhës, duke e bërë Mirditën me 12 bajrakë[40].

Pajtimi me Mirditën ndihmoi edhe në stabilitetin e brendshëm të pashallëkut, pasi konflikti më krahinën e Mirditës i kishte kushtuar shumë Pashallëkut të Shkodrës. Pra të humburit në këtë konflikt nuk ishin veç mirditorët, por dhe Bushatllinjtë. Mustafa pasha dhe paraardhësi i tij kishin shpenzuar shumë energji, ushtri dhe ekonomi për t'u mbrojtur nga sulmet mirditore, të cilat në fakt bëheshin sa herë pashai i Shkodrës ishte i zënë me ndonjë angazhim tjetër të rëndësishëm. Aq më tepër pajtimi me Mirditën do i siguronte sërish Mustafa pashës, përveç qetësisë, kontigjentin e ushtarëve të rëndësishëm e të zotë të Mirditës në luftërat që do bënte.

Pas marrëveshjes, nga mbarimi i nëntorit, Preng Lleshi vdiq[41]. Ka një ide sikur ky u helmua me helmin që i çoi Ali Pasha, i cili e kishte futur atë: *"..... ...ne do tirq qung, te cilhet per bot si i veshi bari qi kishin mmrenn prej kamesh i muer shtatin, e per pak dit e mmyti"*[42]. Drejtimi i Mirditës i kaloi tashmë Dodë Prengës.

Edhe në rastin e Dodës u acaruan në fillim marrëdhëniet me Bushatllinjtë e Shkodrës, por shumë shpejt palët u ulën. Dodë Prenga u prit miqësisht në Shkodër. Madje, ndryshe nga sa deklaron Zef Harapi më sipër, thuhet se pikërsiht për këtë miqësi të re Mustafa Pasha i lëshoi Mirditës bajrakun e Dibrit[43]. Në fakt bajraku i ishte dhuruar Mirditës që në marrëveshjen e bërë, por ndoshta tani iu dorëzua zyrtarisht kapedanit të ri të Mirditës.

Normalisht, marrëveshja me Mirditën ishte e nevojshme dhe këtë, për të gjitha arsyet që kemi përmendur më sipër, e kuptoi më së miri Mustafa Pasha. Mendoj se në këtë rast duhet të këtë ndërhyrë patjetër Porta e Lartë, e cila nuk ishte e interesuar, madje i bënte dëm të madh një konflikt i tillë në këtë moment. Për t'i shërbyer edhe më shumë këtij pajtimi vetë Mustafa Pasha u bë vëlla gishti me kapidan Dodë Prengën dhe nga ky moment miqësia zgjati deri në ditët e fundit të sundimit të Bushatllinjëve[44]. Rilidhja me Bushatllinjtë normalisht preu dhe marrëdhëniet e Mirditës më Ali Pashën. Kjo u dëshmua qartë edhe më 1820 kur Ali Pasha thirri

[35]*Burime të zgjedhura....III,* "Pjesë nga kronika e Dajçit të Zadrimës. – Ngjarjet e sanxhakut të Shkodrës. Lufta e Prenk Lleshit dhe besëlidhurve të tij kundër sundimit të Mustafa pashës përfundon me konsolidimin e pushtetit të Bushatliut", fq 304.
[36]Naçi, *Pashalleku….(1796-1831)*, fq 125.
[37]Elsie, *Fiset shqiptare…..,* fq 330.
[38]Hecquard, *Historia dhe përshkrimi….,* fq 224.
[39]Harapi, *Mirdita në histori....,* fq 44.
[40]Elsie, *Fiset shqiptare…..,* fq 322.
[41]*Burime të zgjedhura....III,* "Pjesë nga kronika e Dajçit të Zadrimës. – Ngjarjet e sanxhakut të Shkodrës. Lufta e Prenk Lleshit dhe besëlidhurve të tij kundër sundimit të Mustafa pashës përfundon me konsolidimin e pushtetit të Bushatliut", fq 305.
[42]Pa autor, *Dera e Gho Markut….,* fq 132.
[43]Po aty, fq 133.
[44]Nikaj, *Historia….,* fq 129.

një kuvend nga gjithë Shqipëria për t'i dalë kundër sulltanit. Mirditorët e kundërshtuan këtë. *"Pashallarë e priftën, muhamedan e kristjan kjenë thirrë prej tij për me i dalë zot vendit tue i falë të gjithve lirin e plotë"*, por në atë mbledhje Preng Llesh Gjoni[45] i Mirditës kundërshtoi dhe nuk pranoi të ngrihej kundër Sulltanit dhe gjithë Mirdita u nda nga kjo lëvizje[46]. Pastaj kapedani i Mirditës u largua dhe i mori me vete të gjithë, duke mos lënë asnjë mirditor në shërbim të Ali Pashës[47].

Kur shpërtheu kryengritja antiosmane greke, Mustafa Pasha mori pjesë me shumë ushtarë në shërbim të Portës së Lartë. Në ushtrinë e tij pati një kontigjent të madh mirditorësh, bashkë me shumë shqiptarë të tjerë, që vijonin të përkrahnin ushtarakisht osmanët. Mendohet se në kohën e kësaj kryengritje të vitit 1823, 15 mijë gegë e 5 mijë toskë u rreshtuan përkrah Turqisë në betejën që u bë në Kapërnisë të Etolisë, ku trupat mirditore komandoheshin nga Preng Lleshi[48] e Lleshi i Zi[49].

Trimëritë e miridtorëve u vunë re që në fillim. Është për t'u përmendur se një nga heronjtë e luftës për pavarësi të Greqisë, Marko Boçari, shqiptar në origjinë, e gjeti vdekjen nga një mirditor. Atë e vrau Lleshi i Zi, kur Marko Boçari po tentonte të vriste Mustafa Pashën[50]. Kjo ka ndodhur natën e 20-21 gushtit 1823, kur Marko Boçari u vu në krye të një pjese të forcave greke, që ndodheshin në grykat e Agrafës. Natën ai filloi sulmin kundër kampit të forcave shqiptare. Marko Boçari depërtoi thellë duke hyrë deri në çadrën e shtabit të forcave shqiptare, ku u plagos rëndë nga Lleshi i Zi, të cilin varianti grek i historisë e konsideron atë zezak (maur)[51]. I plagosur pas përleshjes me Lleshin e Zi, Marko Boçari u largua nga ushtarët e tij, por nuk mundi të mbijetonte. Në fakt njihet dhe shfrytëzimi nga Porta i kontigjenteve shqiptare për të luftuar vëllezërit e vet, jo vetëm jashtë kufirit por dhe brënda vendit në disa raste. Kjo mund të cilësohet si një nga plagët më të mëdha që shoqëroi historinë e Shqipërisë gjatë pushtimit osmnan. Për t'i shkuar në linjë kësaj që sapo thashë më sipër, At. Paulin Margjokaj shkruan për përleshjen mes Lleshit të Zi e Morko Boçarit se: *"Dy burra shqiptarë aq të njoftun nuk mendojnë aspak se janë shqiptarë, por lëshohen furishem me mbytë njani tjetrin"*[52].

Sikur të mos mjaftonte ky shërbim ndaj Portës, në kthim Dodë Prenga me trupat e tij u drejtuan për të shtypur edhe një revoltë në Dibër, ku kjo e fundit kishte dalë nga sundimi i Mustafa Pashës[53]. Ai e nënshtroi Dibrën, e cila qëndroi në këtë gjendje nën Bushatllinjtë edhe për një vit e gjysëm[54].

Në fakt edhe në luftën e Turqisë me Rusinë, që shpërtheu në vitin 1829, trupa të tëra mirditorësh u rreshtuan përkrah atyre turke. Mirditorët ishin pjesë e trupave ushtarake të Mustafa Pashës. Por, duhet theksuar se në këtë luftë spikati Nikollë Prenga, gjyshi i Preng Bibë Dodës. Zef Harapi na shkruan për një episod shumë të veçantë gjatë luftës. Në vendin ku ishin vendosur trupat turke e normalisht dhe mirditorët, këto të fundit nën drejtimin e Lleshit të Zi, rastisi që nata e pushimit të ishte nata e Pashkëve. Lleshi i Zi i kërkoi priftit të zonës që të ngrinte mëshë sipas traditës së kësaj nate, por prifti ngurroj, duke menduar se kjo do ngjallte reaksion tek *"shkjete e vendit"*. Kjo nuk u prit mirë nga ushtarët katolik dhe Lleshi i Zi e detyroi priftin ta jepte meshën në atë moment. Këtë sjellje të Lleshit të Zi nuk e dënoi Mustafa Pasha, përkundrazi e përkrahu[55]. Kjo dëshmon se raporti mes mirditorëve dhe Bushtallinjëve ishte shumë i konsoliduar tashmë.

[45]Autori e ngatërron, pasi Preng Lleshi ka vdekur para kësaj ngjarje. Përsoni në fjalë është Dodë Prenga.
[46]AQSH, fondi nr. 586, dosja nr. 116, viti 1929, f 9.
[47]Pa autor, *Dera e Gho Markut…..,* fq 132.
[48]Autori sërish e ngatërron, pasi Preng Lleshi ka vdekur para kësaj ngjarje. Përsoni në fjalë është Dodë Prenga.
[49]AQSH, fondi nr. 586, dosja nr. 116, viti 1929, f 10.
[50]Thalloczy, *Të ndodhunat…..,* fq 186.
[51]Naçi, *Pashalleku….(1796-1831)*, fq 141.
[52]Paulin Margjokaj, *Lëvizja e madhe per çlirimin kombtar*, revista "Shejzat", viti XIII, 1969, nr. 1-3 (Kallënduer-Mars), fq 81.
[53]Elsie, *Fiset shqiptare….,* fq 331.
[54]Pa autor, *Dera e Gho Markut…..,* fq133.
[55]AQSH, fondi nr. 586, dosja nr. 116, viti 1929, f 11-12.

Gjatë kësaj luftë Mustafa Pasha i Shkodrës me shtatë pashallarë dhe kapidanët e Mirditës në krah, me 35 mijë vetë hynë në Bullgari e pushtuan shumë territore. Ndërkohë situata e Turqisë u ndërlikua, pasi shpërtheu kryengritja në Bosnje, Thesali e në Misir. Por Franca dhe Anglia e shpëtuan nga shkatërrimi sulltanin nëpërmjet paqes së Edrenesë. Mustafë Pasha u detyrua të kthehej në Shkodër me trupat e tij[56].

Sa kohë Mustafa Pasha ishte gjallë, mirditorët luftuan përkrah tij dhe i qëndruan paktit të vitit 1815. Por, kur Mustafa Pashës, i ekzaltuar nga sukseset e tij, i hyri vetja në qejf dhe filloi të organizohej kundër turqve, mirditorët u tkurrën. Atij, nga paria e Mirditës, i qëndroi përkrah në këtë rast vetëm Lleshi i Zi me disa mirditorë.

Në fakt, që nga koha e kryengritjes greke kundër Turqisë, raporti i Mustafa Pashës me osmanët nuk ishte i mirë. Kjo u pa në mefshtësinë e organizimit të ushtrisë së tij në favor të Portës, si dhe u dallua edhe në kohën e luftës ruso-turke. Loja e bushatlliut e bindi sulltanin të fillonte procesin e zhveshjes së pushtetit të tij, duke i hequr territore e pushtet. Në këto kushte Mustafa Pasha filloi të kundërshtonte vendimet e Portës dhe nuk ngurroi të përplasej dhe ushtarakisht, përplasje që do sillte dhe fundin e Bushatllinjve. Normalisht për këtë pashai i Shkodrës kishte marrë dhe nxitjen e përkrahjen nga jashtë, kryesisht të Millosh Obrenoviçit të Serbisë dhe Mehmet Aliut të Egjiptit[57]. Po ashtu, ai kishte mbështetje edhe nga pashallarë vendas dhe një mbështetje e madhe i erdhi nga një pjesë e mirditorëve. Më 1831 mes Portës së Lartë e Mustafa Pashës shpërtheu lufta. Mendohet se mirditorët e ndihmuan shumë Mustafa Pashën në betejen e Babunës, ndonëse nuk është krejt e qartë. Gjithsesi thuhet se më 3 maj në këtë betejë, ushtria e Mustafa Pashës u thye. Ajo mundi të tërhiqej vetëm falë qëndresës së madhe që bënë për 10 ditë rresht mirditorët të fshehur pas kodrave të Babunës, duke mbajtur në vend ushtritë e Reshid Pashës, por më pas u detyruan të lëshojnë pozicionet, të largoheshin e të vijonin qëndresën në kalanë e Shkodrës[58]. Forcat e Mahmut Reshid pashës rrethuan kalanë por më kot, pasi qëndresa ishte e rreptë. Përkrah Mustafa Pashës qëndronin në kala trimërisht edhe 150 mirditorë e Malësorë[59]. Mirditorët i drejtonte Lleshi i Zi dhe vetëm pas katër muajve rrethim, kur një gjyle topi ra në rezervat e barotit duke e shpërthyer të gjithin, Mustafë Pasha u dorëzua. Kapidan Lleshi i Zi u kap dhe u burgos në burgjet e Janinës[60]. Ai mundi të rikthehej vetëm më 1837. Mendohet se për të shpëtuar Mustafa Pashën e për ta nxjerrë atë nga kalaja, Lleshi i Zi organizoi 30 mirditorë të zgjedhur më në krye Preng Mar Kolën, i cili mbeti i vrarë në këtë përpjekje[61].

Kur ranë Bushatllinjtë, mirditorët u rivitalizuan lidhjen e drejpërdrejtë e tradicionale me qeverinë turke. Ato e ruajtën pjesërisht pavarësinë e tyre, por iu rikthyen zakonit të vjetër t'i shërbenin sulltanit në beteja të ndryshme[62].

References

[1] Arkivi Qëndror i Shtetit, fondi *"Zef Harapi",* nr. 586, viti 1929.

[2] *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë. Shqipëria nën sundimin feudal-ushtarak otoman*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Intituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, vëllimi III (1506-1839), pergaditur nga Injac Zamputi, Stavri Naçi dhe Zija Shkodra (Tiranë; Mihal Duri, 1961).

[3] Stavri N. Naçi: "*Pashalleku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllijve (1757-1796)"*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë (Tiranë: 1964).

[4] *Histori e popullit shqiptar.* Vëllimi I. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Botimet "Toena". Tiranë, 2002.

[56]Po aty, f 12.
[57]*Historia e popullit shqiptar I*, fq 688.
[58]Nikaj, *Historia…..,* fq 157.
[59]Paulin Margjokaj, *Lëvizja e madhe per çlirimin kombtar, r*evista "Shejzat", viti XIV, 1970, nr. 1-3 (Kallënduer –Mars), fq 32-33.
[60]AQSH, fondi nr. 586, dosja nr. 116, viti 1929, f 14.
[61]Pa autor, *Dera e Gho Markut…..,* fq 133.
[62]Franc Nopça: *"Fiset e Malësisë së Shqipërisë veriore dhe e drejta zakonore e tyre". Përkthyer nga Dr. Jur. Mihallaq Zallari. Qendra e Studimeve Albanalogjike, Instituti i Historisë. Shtëpia botuese "ENEAS", Tiranë, 2013,* fq 242.

[5] Hyacinthe Hecquard: "*Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së epërme ose i Gegërisë"*. Përktheu nga frengjishtja dhe pajisi me shënime Oriana Tamburi, Plejad 2008.
[6] Robert Elsie: *"Fiset shqiptare. Histori, shoqëria dhe kultura".* Përktheu nga anglishtja Prof. Dr. Abdullah Karjagdiu. "Botime Artini". Prishtinë, 2017.
[7] Pal Doçi: *"Mirdita vatër e qëndresës antiosmane",* shtëpia botuese "Mirdita". Tiranë, 1999.
[8] *Shqipëria e veriut në shekullin e XVIII (Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë, 6),* Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë. Letra të Zev. Konsujve venedikas të Shkodrës, vëllimi II (1757-1802), pergaditur për botim nga Stavri N. Naçi (Tiranë: 1975).
[9] Stavri N. Naçi: "*Pashalleku i Shkodrës (1796-1831)",* Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1986.
[10] Pa autor: "*Dera e Gho Markut a e Kapidanit Mirdites"*, revista "Albania", viti 1898 (Dzhvillim B), nr 8.
[11] Zef Harapi: "*Mirdita në histori e gojdhana deri në vjetë 1929"*, revista "Hylli Dritës", vjeta VII, 1931, nr 1.
[12] Dom Ndoc Nikaj: "*Historia e Shqypnis".* Ribotim i shtypshkronjes "Nikaj" (botimi i parë është bërë në Bruksel me 1902). Shkodër, 1916 (mundet edhe 1917 ose 1918).
[13] Ludwig von Thalloczy: "*Të ndodhunat e Shqypnis prej nji Gege që don vendin e vet"*, përktheu nga gjermanishtja Stefan Zurani, transkriptoi, dokumentoi e komentoi Raim Beluli (Shkodër: Botime Françeskane, 2008).
[14] Mustafa Merlika – Kruja: "*Shkrime historike",* Tiranë, OMSCA-1, 2011.
[15] P. Margjokaj: "*Epizode historike nga koha e Ali Tepelenës. Kerdija në popullsin e Kardhiqit", r*evista "Shejzat", viti II, 1958, nr. 3-4 (Mars-Prill).
[16] Pal Doçi: *"Vetëqeverisja e MIRDITËS".* Shtëpia Botuese Enciklopedike. Tiranë, 1996.
[17] Paulin Margjokaj, *Lëvizja e madhe per çlirimin kombtar*, revista "Shejzat", viti XIII, 1969, nr. 1-3 (Kallënduer-Mars).
[18] Paulin Margjokaj, *Lëvizja e madhe per çlirimin kombtar, r*evista "Shejzat", viti XIV, 1970, nr. 1-3 (Kallënduer –Mars).
[19] Franc Nopça: *"Fiset e Malësisë së Shqipërisë veriore dhe e drejta zakonore e tyre". Përkthyer nga Dr. Jur. Mihallaq Zallari. Qendra e Studimeve Albanalogjike, Instituti i Historisë. Shtëpia botuese "ENEAS", Tiranë, 2013*.